



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit:21.12.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË
ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti, i mbështetur nga, Arian Haxha (Udhëheqës Ekipi), Adelina Selmani dhe Laureta Matoshi (Anëtare Ekipi).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	10
4 Qeverisja	11
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	25
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	28


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga Auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Ministrin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 19/09/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.


Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

(ISSAI 200/1700 Opinion i Pamodifikuar)

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigje nga Menaxhmenti - auditimi i vitit 2014

Menaxhmenti është pajtuar me të gjeturat dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të outputeve cilësore operacionale. Kjo, për shembull, mund të jetë një aktivitet monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operacionale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetme ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Draft PVF-të e pranuar nga MAPL-ja kishin gabime materiale të cilat pas këshillave të dhëna nga ne, janë korrigjuar. PVF-të e korrigjuara kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara të Sektorit Publik "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 06/2011.

Po ashtu të gjitha obligimet e tjera të raportimit të jashtëm ishin përmbushur plotësisht.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

(ISSAI 200/1700 Opinion i Pamodifikuar)

2.2 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

MAPL-ja duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€.
- Raportet për borxhet e papaguara;
- Plani preliminar dhe final të prokurimit; dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit.

Në draft PVF-të kishte pasur nevojë që të bëheshin disa korrigjime financiare të cilat i kemi paraqitur më poshtë. MAPL ka bërë korrigjimet e nevojshme në PVF, prandaj - Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me dorëzimin e draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtet.

Çështja 1 - Prodhimi i PVF - Prioritet i lartë

E gjetura	<p>Proceset jo efektive të aplikuara gjatë rishikimit menaxherial të PVF-ve kanë ndikuar në paraqitjen e gabimeve në vijim:</p> <p>Në raportin e ekzekutimit të buxhetit, tek pjesa e hyrjes së parasë së gatshme ishte paraqitur gabimisht buxheti final nga donacionet në vlerë 36,482€.</p> <p>Po ashtu realizimi nga donacionet për vitin 2013 ishte paraqitur në vlerë 42,206€ ndërsa sipas shënimeve të SIMFK-së realizimi ishte 139,215€.</p> <p>Më tutje, edhe realizimi nga donacionet për vitin 2012 ishte paraqitur 40,154€ ndërsa sipas SIMFK-së ishte 30,218€.</p> <p>Si pasoj e kësaj edhe shënimet shpjeguese nuk ishin të sakta.</p>
Rreziku	<p>Paraqitja jo e saktë e PVF shpie në një keqkuptim të pozitës financiare të institucionit. Gabimet materiale ndikojnë që PVF-të të jenë subjekt i modifikimit të opinionit ose theksimit të çështjes.</p>
Rekomandimi 1	<p>Ministri duhet të sigurojë se zbatohet një proces efektiv gjatë përgatitjes së PVF-ve 2015 i cili adreson dobësitë e identifikuara në PVF 2014. Para dërgimit në Qeveri, PVF duhet të nënshkruhen vetëm pas një shqyrtimi gjithpërfshirës nga ana e menaxhmentit për të siguruar përmbajtjen dhe saktësinë e PVF.</p>

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Pas pranimit të rekomandimeve tona në raportin e auditimit të vitit 2013, MAPL-ja kishte hartuar planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve. Megjithatë nuk ka arritur ta implementoj në tërësi dhe për rrjedhojë mangësi të njëjta janë vërejtur në disa fusha të caktuara. Është e rëndësishme të ndërmerren veprime shtesë për implementimin e plotë të rekomandimeve në mënyrë që mangësitë e njëjta të mos përsëriten.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 të MAPL-së ka rezultuar me 11 rekomandime kryesore. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, katër (4) rekomandime janë adresuar plotësisht, pesë (5) janë adresuar pjesërisht, dhe dy (2) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 2 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura MAPL-ja nuk ka arritur të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për adresimin e plotë të rekomandimeve të AP-së. Si pasojë mangësitë e njëjta janë përsëritur në fushën e planifikimit dhe realizimit të buxhetit për kapitale, menaxhimit të shpenzimeve, pasurisë dhe borxheve.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, kanë rezultuar me:

- Mangësi në planifikimin dhe realizimin e buxhetit për kapitale;
- Mungesën e analizave të duhura lidhur me nevojat reale të MAPL-së për furnizime; dhe
- Rritjen e obligimeve për shkak dështimit në zotimin e fondeve me kohë.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të sigurojë se rekomandimet e AP-së trajtohen me kujdes të shtuar nga të gjitha nivelet e përgjegjësive me qëllim të adresimit të tyre të plotë dhe me kohë.

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes janë adresuar nga MAPL si në vazhdim:

Vetëvlerësimi –është zbatuar mirëpo cilësia dhe objektiviteti i procesit ishin të pamjaftueshme. Një proces objektiv i vetëvlerësimit shërben si pikënisje për të zhvilluar sisteme efektive të MFK-së si dhe për të përmirësuar performancën e përgjithshme të organizatës.

- Raportimi i brendshëm për menaxhmentin ishte adekuat, në përjashtim të raportimit lidhur me pasuritë. Përkundër raportimit të rregullt kontrollet nga menaxhmenti nuk ishin adekuate.
- Auditim i brendshëm nuk ka arritur të jetë efektiv në kryerjen e planit vjetor të auditimit. Njëkohësisht as menaxhmenti nuk kishte përgatitur planin e veprimit për adresimin rekomandimeve të AB-së.

Ndërkohë që kontrollet mbi disa fusha janë të forta dhe po zbatohen në mënyrë efektive, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që MAPL të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të pasurive. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë Mallrat dhe Shërbimet, Subvencionet dhe Pasuria.

4.1 Qeverisja e mirë

Përshkrim

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Megjithatë ato nuk ishin zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha fushat kyçe. Është e rëndësishme që raportimet nga njësit vartëse tek menaxhmenti të shqyrtohen në mënyrë kritike për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 3 – Aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes- Prioriteti i lartë

E gjetura	<p>Disa aspekte të qeverisjes së mirë nuk kanë funksionuar si duhet në MAPL.</p> <ul style="list-style-type: none">• Rishikimi që ne i kemi bërë kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të MAPL-së ka nxjerrë në pah një raportim të dobët mbi menaxhimin e pasurive tek menaxhmenti i lartë. Kjo ka ndikuar në menaxhimin e dobët të pasurisë;• Edhe përkundër raportimeve të rregullta formale nga njësit vartëse për fushën e subvencioneve, personelit si dhe mallrave dhe shërbime, ato nuk janë shfrytëzuar në mënyrë efektive nga menaxhmenti për të parandaluar gabimet sistematike në këto fusha; dhe• Kërkesa për të aplikuar vetëvlerësim është adresuar vetëm formalisht pasi që rëndësia për të mbështetur menaxhimin efektiv nuk është identifikuar plotësisht nga MAPL. Në listat kontrolluese vetë vlerësuese nuk ishin paraparë masat kryesore apo rekomandimet për përmirësimin e fushave me mangësi dhe pohimet në vetëvlerësim nuk ishin mbështetur me dëshmi përkatëse.
E gjetura	<p>MAPL-ja nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve (regjistri i rreziqeve) në nivel të organizatës që do të zbusnin ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërlidhen me arritjen objektivave.</p>
Rreziku	<p>Raportimi i dobët mbi menaxhimin e pasurisë tek menaxhmenti i lartë e ka reduktuar aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar në mënyrë aktive pasurinë e MAPL-së. Më tutje, mos aplikimi i kontrolleve në mënyrë efektive nga Menaxhmenti rezulton në dobësi në procesin e shpenzimeve dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta.</p>
Rekomandimi 3	<p>Ministri duhet të rishqyrtoj shkaqet e mos aplikimit të kontrolleve në mënyrë efektive në fushën e pasurisë, subvencioneve dhe menaxhimit të burimeve njerëzore dhe të adresoj dobësitë e theksuara në menaxhimin e tyre.</p> <p>Po ashtu të siguroj që listat kontrolluese vetë vlerësuese si dhe regjistrat e rrezikut shfrytëzohen nga menaxhmenti si mjete të cilat testojnë efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të tyre të punës.</p>

4.2 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MAPL, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	5,050,000	5,178,441	4,259,816	4,919,403	5,792,704
Granti i Qeverisë -Buxheti	5,050,000	5,037,474	4,148,756	4,877,197	5,752,550
Donacionet e jashtme	-	140,967	111,060	42,206	40,154

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 128,441€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të jashtme në vlerë 140,967€ dhe zvogëlimit të grantit Qeveritar për 12,526€.

Në vitin 2014, MAPL ka shfrytëzuar 82% të buxhet final, me një përmirësim prej 2% krahasuar me vitin 2013. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	5,050,000	5,178,441	4,259,816	4,919,403	5,792,704
Pagat dhe Mëditjet	756,746	812,621	809,979	666,931	696,535
Mallrat dhe Shërbimet	356,005	483,071	446,250	390,365	649,265
Shërbimet komunale	30,000	25,500	18,878	25,724	23,401
Subvencionet dhe Transferet	437,249	378,249	372,007	468,125	390,063
Investimet Kapitale	3,500,000	3,479,000	2,612,702	3,368,258	4,033,440

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për Paga dhe Mëditje në krahasim me buxhetin fillestar është rritur për 55,875€. Prej tyre 34,874€ ishin ndarë për financimin e vendimit të Qeverisë për rritje të pagave prej 25% ndërsa pjesa tjetër prej 21,000€ ishte për stafin e përfshirë në “Fondin për Kuadro.”
- Buxheti final për Mallra dhe Shërbime në krahasim me buxhetin fillestar është zvogëluar për 49,000€ (vendimi i Qeverisë për kursime buxhetore prej 15%). Pastaj është rritur për 206,000€. Prej tyre, 44,000€ janë transferuar nga subvencione dhe transfere dhe 33,000€ nga investime kapitale. Ndërsa, 129,000€ tjera ishin grand i Komisionit Evropian për bashkëpunim ndërkuftar. Buxheti për këtë kategori është realizuar 446,250€ apo 92%.
- Buxheti final për Shërbime komunale në krahasim me buxhetin fillestar është zvogëluar për 4,000€ (vendimi i Qeverisë për kursime buxhetore prej 15%). Buxheti për këtë kategori ishte realizuar 18,878€ apo 75%.
- Buxheti final për Subvencione dhe Transfere krahasuar me atë fillestarë fillimisht është rritur për 15,000€ (me vendim të Qeverisë), pastaj është zvogëluar 74,000€ (44,000€ janë transferuar tek mallrat dhe shërbimet dhe 30,000€ në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale). Buxheti final për këtë kategori është realizuar 372,007€ apo 91 % .
- Buxheti final për Investime Kapitale në krahasim me buxhetin fillestar është zvogëluar për 13%. Pavarësisht zvogëlimit, buxheti final për këtë kategori është shpenzuar vetëm 75%.

Çështja 4 - Realizimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Buxheti për investime kapitale është realizuar vetëm 75% dhe atë 56% e buxhetit është shpenzuar në dy muajt e fundit të vitit. Kjo ka ndodhur për shkak të vonesave në aprovimin e projekteve nga ana e Ministrit dhe për shkak të vonesave në realizimin e procedurave të prokurimit nga ana e Komunave.
- Rreziku** Niveli i ulët i realizimit të buxhetit tek investimet kapitale do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës siç është efikasiteti i pushtetit lokal dhe reforma e administratës lokale. Kjo do të ketë për pasoj edhe ngarkimin e buxhetit 2015 për shlyerjen e detyrimeve nga viti i kaluar.
- Rekomandimi 4** Ministri duhet të sigurojë një vlerësim sistematik të arsyeve në lidhje me nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit që ndërlidhet me investimet kapitale. Procesit të aprovimit të projekteve kapitale duhet ti kushtohet më shumë rëndësi për të gjetur dhe evituar pengesat në fazën e hershme. Po ashtu, të shtoj bashkëpunimin me Komunitet me qëllim të rritjes së efikasitetit në kryerjen e obligimeve me kohë nga të dy palët.
-

4.3 Shpenzimet

4.3.1 Prokurimi

Gjatë vitit 2014, MAPL-ja përmes procedurave të prokurimit kishte shpenzuar 2,820,924€. Ne kemi testuar 33 pagesa në vlerë prej 94,592€ nga kategoria Mallra dhe shërbime si dhe 60 pagesa në vlerë prej 2,083,216€ nga kategoria e Investimeve kapitale. Gjithashtu, për të vlerësuar nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me dispozitat e ligjit të prokurimit publik, kemi testuar 8 procedura të prokurimit. Në bazë të marrëveshjeve ndërmjet MAPL-së dhe komunave për investimet kapitale të financuara për komuna, procedurat e prokurimit ishin realizuar nga komunat.

Çështja 5 - Dobësi në prokurim - Prioritet i Lartë

E gjetura **Përzgjedhja e Operatorëve Ekonomik (OE) në listën e ngushtë në mungesë të veprimtarisë përkatëse.** Në dy aktivitete të prokurimit², OE të përzgjedhur në listën e ngushtë nuk kishin të regjistruar në veprimtarinë për të cilën kishin aplikuar për tender.

Furnizimi me shërbime për reklama dhe konkurse pa zhvillimin e procedurave të prokurimit. Shpenzimet për reklama dhe konkurse gjatë vitit 2014 ishin në vlerë 3,580€. Këto shërbime ishin kryer në bazë të një marrëveshje mirëkuptimi të lidhur në fillim të vitit ndërmjet Sekretarit të MAPL dhe shtatë (7) gazetave vendore. Sipas kësaj marrëveshje shpalljet janë bërë me rotacion në secilën gazetë nga njëherë përkundër faktit që çmimet ishin të ndryshme mes këtyre gazetave për formate të njëjta. Mos përfillja e procedurave të prokurimit ka ndikuar në sigurimin e shërbimeve me çmime më të larta.

Furnizimi me bileta për udhëtime zyrtare pa zhvillimin e procedurave të prokurimit. Shpenzimet për udhëtime zyrtare jashtë vendit-bileta të udhëtimit, gjatë vitit 2014 ishin në vlerë 22,400€. Sigurimi i këtyre shpenzimeve në disa raste ishte bërë duke aplikuar metodën e blerjeve minimale e në disa raste tjera ishin shfrytëzuar kontratat nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Zyra e Kryeministrit. Mos zhvillimi i procedurave të hapura për sigurimin e këtyre shërbimeve, sipas zyrtarit të prokurimit ishte bërë për shkak të mos planifikimit tyre.

² a) Tek aktiviteti i prokurimit për "furnizim me mobilje" në vlerë 4,997€, procedur me kuotim të çmimeve vetëm dy nga tre operatorët ekonomik kishte të regjistruar biznesin për veprimtari përkatëse siç është prodhimi i produkteve prej druri si dhe ndërmjetësimi në tregtinë e mobiljeve.

b) Po ashtu tek aktiviteti i prokurimit për "furnizim me pajisje të TI" në vlerë 5,820€, procedur me kuotim të çmimeve vetëm njëri nga tre ofertuesit kishte të regjistruar biznesin për veprimtarinë përkatëse.

Rreziku Mos zhvillimi i procedurave të prokurimit siç parashihet me LPP për sigurimin e biletave të udhëtimit dhe shërbimeve, kufizon konkurrencën dhe ulë nivelin e transparencës ku si pasojë çmimet për shërbimet e pranuar mund të jenë më të larta. Më tutje, përzgjedhja në listën e ngushtë e OE që nuk kanë veprimtarin përkatëse, mund të ndikojë që furnizimet e siguruar të mos jenë të cilësisë së duhur.

Rekomandimi 5 Ministri duhet të sigurojë që Sekretari i Përgjithshëm ka ndërmarr veprimet adekuate për planifikimin me kohë të furnizimeve gjatë vitit me qëllim të evitimit të anashkalimit të kërkesave ligjore si dhe të zhvilloj proceset e prokurimit për siguruar transparencë, konkurrencë dhe vlerën për parane e shpenzuar. Po ashtu, ka shtuar llogaridhënien tek zyrtarët përgjegjës për vlerësimin e ofertave me qëllim që në listën e ngushtë përzgjidhen vetëm OE të cilët kanë të regjistruar dhe kryejnë veprimtarinë përkatëse

Çështja 6 - Dobësi në klasifikim dhe procedimin e pagesave - Prioritet i mesëm

E gjetura **Vonesë në kryerjen e pagesave.** Organizata buxhetore (OB) duhet që çdo faturë të vlefshme ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës. Në nëntë (9) raste faturat/ obligimet ndaj furnitorëve në vlerë prej 9,945€ ishin paguar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditësh. Vonesat varionin nga 66 deri në 84 ditë.

Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve. Shpenzimet në vlerë prej 2,310€ për blerjen e dy lloptopëve të cilat për nga natyra i përkasin kategorisë së investimeve kapitale ishin planifikuar, procesuar dhe raportuar në kategorinë mallra dhe shërbime.

Pagesa nga mallrat dhe shërbimet për Komunën e Ranillugës. Komuna e Ranillugës ka parashtruar kërkesën në MAPL për pagesën e shpenzimeve për ngrohje “dru dhe qymyr për shkolla” me arsyetimin se nuk kishin buxhet të mjaftueshëm. Bazuar në këtë kërkesë, MAPL kishte kryer pagesën për “dru dhe qymyr” në vlerë prej 19,200€ nga buxheti për mallra dhe shërbime. Blerja e tillë është dashur të bëhet nga kategoria e subvencioneve nëse ishin plotësuar kriteret siç parashihet me rregulloren për subvencionim, e jo nga kategoria mallra dhe shërbime.

Rreziku Mos pagesa e shpenzimeve brenda afatit kohor ligjor, si dhe pagesa e shpenzimeve nga kodet dhe kategoria ekonomike joadekuate ndikojnë që ekzekutimi i buxhetit të mos bëhet sipas planit dhe për pasojë obligimet në fund të vitit mund të rriten dhe të mos arrihen objektivat e synuara.

Rekomandimi 6 Ministri duhet të sigurojë se ka shtuar llogaridhënien dhe përgjegjësinë tek zyrtarët financiar për tu siguruar që faturat e pranuar paguhen brenda afatit kohor ligjor si dhe nga kategoria ekonomike adekuate.

4.3.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Ne kemi testuar gjithashtu shpenzimet për të cilat nuk kërkohet aplikimi i procedurave të prokurimit siç janë: Shërbimet komunale, shpenzimet e reprezentacionit, shpenzimet e udhëtimeve Zyrtare dhe shpenzime tjera. Kontrollat në këtë fushë kanë funksionuar mirë, megjithatë duhet të ndërmerren veprime shtesë për eliminimin e mangësive në vijim.

Çështja 7 - Tejkalim i shpenzimeve të telefonisë fikse dhe vonesa në mbylljen e avanseve - Prioriteti i lartë

E gjetura **Mos aplikimi i ndalesës në paga për tejkalim të shpenzimeve të telefonisë.** Sipas një vendimi të Sekretarit Permanent, tejkalimet e limiteve të shpenzimeve të telefonisë fikse dhe mobile të përcaktuar me UA nr.04/2008 duhet të ndalen nga pagat. Në dy (2) muaj kishte tejkalim të shpenzimeve të telefonisë fikse në vlerë prej 765€ dhe ndalesat në paga nuk ishin aplikuar. Sipas MAPL-së ndalesat nuk janë aplikuar me arsyetimin se stafi kishte angazhime shtesë, mirëpo nuk kishte dëshmi sa i përket këtyre angazhimeve.

Mos mbyllja me kohë e avanseve për udhëtime zyrtare. Sipas UA nr. 2004/07 të gjitha avanset duhet të mbyllën 15 ditë pas kthimit nga udhëtimi zyrtarë. Në tetë (8) raste avancet në vlerë prej 6,108€ ishin mbyllur pas afatit kohorë ligjorë prej 15 ditësh. Sipas zyrtarëve të MAPL-së, kjo ka ndodhur për shkak të vonesave në sjellen e raporteve bankare meqenëse shpenzimet ishin bërë me kartelë. Raportet nga banka ishin sjellur me datën 5 të muajit vijues për muajin paraprak ndërsa vonesat varionin nga 35 deri në 95 ditë.

Arsyetim i pamjaftueshëm lidhur me aprovimin e shpenzimeve për udhëtime zyrtare. Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit³, do të mbuloheshin nga fondi i Komisionit Evropian Cross Border Cooperation (KECBC). MAPL-ja kishte dërguar listën prej 10 përfaqësuesve për pjesëmarrje megjithatë njëri prej tyre kishte anuluar udhëtimin për shkak të një angazhimi tjetër. MAPL kishte kërkuar nga KE që pjesëmarrës të jetë një zyrtar tjetër, mirëpo KE nuk kishte aprovuar një ndërrim të tillë. Përkundër kësaj, MAPL ka marrë vendim që shpenzimet për këtë zyrtar prej 1,327€ të kompensohen nga buxheti i MAPL-së. Megjithatë, në dokumentet mbështetëse nuk kishte ndonjë arsyetim të duhur për nevojën e pjesëmarrjes së këtij zyrtari në këtë trajnim.

³ Trajnimi me temë bashkëpunimi ndërkufitar që do të mbahej në Austri dhe Kroaci për 10 përfaqësues nga MAPL-ja.

- Rreziku** Aprovimi i shpenzimeve të udhëtimit pa dhënë arsyetimin e duhur për nevojën e pjesëmarrjes në trajnim; mos aplikimi i ndalesave në paga në rastet e tejkalimit të limiteve të shpenzimeve telefonike fikse, si dhe vonesat në mbylljen e avanseve ndikojnë në shfrytëzim jo ekonomik të mjeteve financiare.
- Rekomandimi 7** Ministri duhet të sigurojë mbylljen e avanseve brenda afatit kohor ligjor si dhe aplikimin e ndalesave në paga në rastet e tejkalimit të limiteve të shpenzimeve të telefonisë fikse dhe mobile. Më tutje, aprovimi i udhëtimeve zyrtare bëhet vetëm në rastet kur ka arsyeshmëri të duhur dhe merret parasysh shpenzimi më racional i mjeteve financiare.

4.3.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë nga MAP kanë të bëjnë llogaritjen e pagave në pajtim me kontratat e punës si dhe legjislacionit të aplikueshëm.

Numri i aprovuar për të punësuarit në MAP ishte 141, ndërsa numri aktual i të punësuarve ishte 134 punonjës. Ne kemi testuar disa procedura të rekrutimit, dosjet e personelit si dhe kemi rishikuar listat e pagave dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PVF.

Çështja 8 - Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore - Prioritet i lartë

E gjetura Rezultatet e testimeve tona në fushën e personelit kanë identifikuar çështjet në vijim:

Avancimet jo në pajtueshmëri me kornizën ligjore Në pesë (4) rastet e mëposhtme ishte bërë avancimi në pozitë të zyrtarëve pa procedura të brendshme të avancimit siç e përcakton neni 27 i Ligjit për shërbyes civil dhe rregullorja 21/2012 për avancim në karrierë të nëpunësve civil.

- Zyrtari për zhvillim rajonal (grada 7) ishte avancuar në pozitën zyrtar të lartë për zhvillim rajonal (grada 8);
- Zyrtar për zhvillim të performancës komunale (grada 7) ishte avancuar në pozitën zyrtar të lartë për zhvillim të performancës komunale (grada 8);
- Zyrtari për dosje të personelit (grada 7) ishte avancuar në pozitën zyrtarë të lartë të personelit (grada 8); si dhe
- Zyrtari për të drejtat e njeriut (grada 6) ishte transferuar në pozitën zyrtar për blerje me vlerë të madhe (grada 7) në kuadër të divizionit të prokurimit.

Mos respektimi i procedurave të rekrutimit. Në dy (2) raste procedurat e rekrutimit nuk janë zhvilluar në pajtueshmëri me Ligjin për shërbyesit civil, nuk është respektuar kriteri i konkursit publik lidhur me përvojën e punës⁴. Në të dy rastet kandidatët e pranuar nuk e kanë dokumentuar përvojën e punës siç është kërkuar me konkurs.

Transferimi në pozitë pa përfundimin e periudhës provuese. Pas katër muajve nga punësimi, zyrtarit për Integritet Evropian ishte transferuar në Divizionin për Buxhet dhe Financa ende pa e përfunduar periudhën provuese prej një viti.

Rreziku Mangësitë e tilla krijojnë mundësinë e përzgjedhjes së kandidatëve të cilët nuk i kanë shkathtësitë dhe përvojën e duhur profesionale për pozitën e caktuar, dhe në mungesë të tyre mund të dështojnë në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiave përkatëse.

Rekomandimi 8 Ministri duhet të sigurojë se gjatë rekrutimit të stafit respektohen kriteret e konkursit publik për të siguruar se kandidatët e përzgjedhur kanë shkathtësitë dhe përvojën e duhur profesionale për pozitën e caktuar. Po ashtu, avancimi në pozitë i zyrtarëve bëhet nëpërmjet procedurës për avancim. Më tutje, transferi në ndonjë pozitë tjetër të bëhet vetëm pasi zyrtarët kanë kaluar periudhën provuese.

⁴ Në pozitën Zyrtarë për Monitorim të Komunave është kërkuar tri (3) vite pune, ndërsa për pozitën Zyrtar për Integritet Evropian është kërkuar dy vite përvojë pune.

4.3.4 Subvencionet dhe Transferuat

Përshkrimi

MAPL-ja ka zhvilluar procese të mbikëqyrjes dhe monitorimit për subvencione dhe transfere. Megjithatë, këto proces nuk kanë siguruar plotësisht që subvencionimi bëhet plotësisht në përputhje me objektivat e përcaktuara.

Çështja 9 – Subvencionimi për qëllime tjera nga ato që promovojnë qeverisjen lokale Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas rregullores së brendshme të MAPL-së⁵, ndarja e mjeteve të buxhetit të nga kategoria subvencione dhe transfere bëhet për subjektet fizike dhe juridike me qëllim të avancimit të vetëqeverisjes lokale në ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme dhe transparente.

Në tri (3) raste subvencionimi ishte bërë për qëllime të mëposhtme

- dy pagesa në vlerë 1,000€ janë bërë për pagesën e qerasë dhe ushqimit për dy familje në Komunën e Obiliqit. Sipas MAPL-së, qëllimi ka qenë të ndihmohen familjet të cilat kishin pësuar nga eksplodimi i termocentralit. ndërsa
- Pagesa në vlerë prej 450€ ishte bërë për një zyrtarë të MAPL-së për qëllime shëndetësore,

Rreziku Dhënia e subvencioneve për qëllime tjera prej atyre që promovojnë qeverisjen lokale rrit rrezikun që buxheti për subvencione nuk është shpenzuar në mënyrë efektive dhe për qëllimet e synuara në fillim.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të siguroj që subvencionimi bëhet për qëllime të cilat promovojnë qeverisjen lokale.

⁵ Rregullorja XX për ZZZZ

4.4 Pasuritë dhe detyrimet

4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Sipas regjistrit kontabël të SIMFK-së, vlera neto e pasurive kapitale (mbi 1000€) ishte 6,785,000€, ndërsa vlera e pasurive jokapitale (nën 1000€) ishte 635,000€.

Investimet kapitale të financuara nga MAPL-ja nëpër komuna fillimisht regjistrohen si investime në vijim në regjistrat e pasurisë së MAPL-së. Pas përfundimit të projekteve barten në pronësi të komunave dhe regjistrohen në regjistrin kontabël të tyre.

Auditimi jonë mbi menaxhimin e pasurisë identifikoi çështjet në vijim.

Çështja 10 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë - Prioritet i lartë

E gjetura **Regjistri i Pasurisë i mbivlerësuar.** Në regjistrin kontabël ende janë të regjistruara shtatë (7) automjete në vlerë prej 60,507€ të cilat në vitin 2010 i janë dhënë për shfrytëzim të përhershëm disa komunave në bazë të marrëveshjeve për të mbështetur komunat në ofrimin e shërbimeve të tyre. Transferimi i këtyre automjeteve në komuna ishte bërë pa aprovim paraprak nga MF siç kërkohet me rregulloren nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore, prandaj MF përkundër kërkesës së bërë nga MAPL-ja nuk i kishte larguar këto vetura nga regjistri i pasurisë së MAPL-së në SIMFK.

Mos kthimi i pasurisë nga zyrtarët e larguar nga MAPL. Secili zyrtar i OB me rastin e largimit nga puna duhet të kthejë pasurinë me të cilën ka qenë i ngarkuar e cila është në pronësi të OB. 13 zyrtarë të larguar nga puna, nuk kanë kthyer pasurinë me të cilën kanë qenë të ngarkuar siç janë: llaptopat dhe telefonat mobil me gjithë përpjekjet nga MAPL.

Mos harmonizimi i regjistrit të pasurisë me raportin e inventarizimit. Njehsimi fizik (inventarizimi) i pasurisë për vitin 2014 ishte bërë në përputhje me rregulloren e sipër përmendur. Megjithatë, nuk ishte bërë harmonizimi i të dhënave ndërmjet regjistrit të pasurisë dhe raportit të inventarizimit.

Rreziku Mos largimi nga regjistri kontabël i automjeteve të cilat nuk janë pronë e MAPL-së ndikon që vlera e pasurisë së prezantuar në PVF të jetë e mbivlerësuar. Më tutje, tjetërsimi i pasurisë pa respektuar procedurat ligjore, mos harmonizimi i regjistrit kontabël me raportin e inventarizimit si dhe moskthimi i pasurisë nga zyrtarët e larguar nga puna rrisin rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet apo tjetërsohet.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë menaxhimin e pasurisë në përputhje me kërkesat ligjore. Po ashtu te iniciojë procesin për heqjen e veturave nga regjistri kontabël të cilat nuk janë pronë e ministrisë.

4.4.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara në fund të vitit 2014 ishte 66,392€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2015. Në krahasim me vitin paraprak obligimet e papaguara ishin zvogëluar dukshëm. Faturat për obligimet e papaguara i takonin muajit dhjetor 2014.

Çështja 11 - Obligimet e papaguara -Prioritet i mesëm

E gjetura 52,000€ të obligimeve i takonin kategorisë së investimeve kapitale, deri sa buxheti i shpenzuar në këtë kategori ishte vetëm 75%. Obligimet e papaguara në fund të vitit kryesisht ishin pasojë e vonesave në zotimin e mjeteve dhe nxjerrjes së urdhërblereve.

Rreziku Mos zotimi i mjeteve me kohë dhe nxjerrja e urdhërblereve pas faturës ndikojnë në rritjen e obligimeve të papaguara në fund të vitit të cilat shkaktojnë ngarkesë buxhetore në pasues.

Rekomandimi 11 Ministri duhet të sigurojë se zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhërblereve bëhet para hyrjes në obligime, në mënyrë që vlera e obligimeve të papaguara të ulet në nivel minimal.

4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) për vitin 2014 kishte planifikuar kryerjen e pesë (5) auditimeve të rregullta dhe dy (2) auditimi me kërkesë (ad hok). Deri në fund të vitit NjAB kishte finalizuar tri (3) raporte të auditimit.

Cilësia e raporteve të finalizuara ishte e mirë, përmes këtyre raporteve menaxhmentit i janë ofruar informata dhe vlerësime se sa efektive janë kontrollet e vendosura dhe si funksionojnë ato në fushat përkatëse. Megjithatë, menaxhmenti nuk kishte përgatitur një plan për implementimin e rekomandimeve ku si pasojë kishte ngecje në implementimin e rekomandimeve të NjAB-it.

Komiteti i auditimit kishte mbajtur takime të rregullta tre (3) mujore ku ishin vlerësuar dhe trajtuar raportet e NAB-it.

Çështja 12 –Plani vjetor i punës - Prioritet i lartë

E gjetura NjAB nuk kishte arritur të përmbush plotësisht planin vjetor të punës, vetëm 36 nga 5 auditimet e planifikuara i kishte finalizuar. Një auditim që kishte të bënte me menaxhimin e personelit ishte ndërprerë me kërkesë të menaxhmentit për tu kryer më vonë me arsyetimin se stafi ishte në pushime. Ndërsa në fushën e menaxhimit të investimeve kapitale në dy vitet e fundit nuk është kryer auditim nga NjAB me arsyetimin se shpenzimet në këtë kategori ishin realizuar në fund vit.

Rreziku AB nuk ka ofruar siguri mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme gjatë vitit 2014 në fushën e Investimeve kapitale dhe menaxhimit të personelit. Meqenëse, pjesa më e madhe e buxhetit realizohet në kategorinë e investimeve kapitale, dobësitë e paidentifikuara dhe të pa adresuara mund të rezultojnë në humbje financiare për MAPL-në.

Rekomandimi 12 Ministri duhet të sigurojë se aktiviteti i ardhshëm i AB-së duhet të orientohet drejt zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit të bazuar në rrezik. Kjo do t'i jepte menaxhmentit siguri vjetore për sa i përket efektivitetit (ose e kundërta) të sistemeve të kontrollit të brendshëm për të gjitha rrjedhat shpenzimeve domethënëse.

⁶ Auditimi në fushën e menaxhimit të prokurimit në MAPL, Menaxhimi i automjeteve dhe TI, dhe Menaxhimi I buxhetit, kontabilitetit dhe pagesave.

Çështja 13 - Mos përgatitja e planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve të AB-së - Prioritet i lartë

- E gjetura** NJAB-i gjatë vitit 2014 kishte finalizuar 3 raporte ku ishin dhënë rekomandime, implementimi i të cilave do të ndikonte në përmirësimin e kontrolleve të brendshme të MAPL-së. Megjithatë, menaxhmenti nuk kishte përgatitur plan për implementimin e rekomandimeve të NJAB-it dhe si pasojë kishte ngecje në implementimin e tyre.
- Rreziku** Mos përgatitja e planit për implementimin e rekomandimeve të NJAB-it ku do të përcaktoheshin afatet kohore si dhe stafi përgjegjës për implementimin e tyre, ndikon në mos përmirësimin e kontrolleve të brendshme dhe si pasojë rrisin rrezikun që mangësitë e njëjta të përsëriten.
- Rekomandimi 13** Ministri duhet të sigurojë se përfitimi nga puna e auditimit të brendshëm merret në konsideratë duke përgatitur planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të NJAB-it dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete në implementimin e tyre.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
3.Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Ministri duhet të sigurojë se masat e përcaktuara në planin e veprimit për fushat me mangësi të theksuara rishikohen dhe monitorohen në vazhdimësi për të siguruar që ato adresohen plotësisht nga stafi llogaridhënes.		Pjesërisht	
4.1.Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet ta bëjë një vlerësim sistematik të arsyeve në lidhje me nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit në tërësi, si dhe të eliminoj dobësit qoftë në fazën e planifikimit ose fazën e ekzekutimit të buxhetit.			jo
	Ministri duhet siguroj një monitorim sistematik të performancës buxhetore në baza mujore në mënyrë që ta përmirësoj atë, gjithashtu të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit.		Pjesërisht	
4.2.Shpenzimet 4.2.1.Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë se nevojat për mallra dhe shërbime dhe investime kapitale janë identifikuar me kohë dhe vlera e përafërt e shpenzimit është përcaktuar me qëllim të reduktimit të rreziqeve/devijimeve nga rregullat ligjore. Gjithashtu Ministri, duhet të shtojë nivelin e bashkëpunimit me Komunat në fazën e planifikimit në mënyrë që të bëhet identifikimi i nevojave me kohë dhe të bëhet një planifikim i mirëfillt i shpenzimeve të prokurimit.	po		
	Ministri duhet të sigurojë se ka shtuar kujdesin para nënshkrimit të kontratës për të siguruar zotimin e mjeteve nga kategoria përkatëse si dhe gjatë procedimit të pagesave të siguroj që ato bëhen në përputhje me kodet në planin kontabël.	po		

	Ministri duhet të siguroj që janë forcuar mekanizmat e bashkëpunimit dhe ka shtuar mbikëqyrjen e vazhdueshme gjatë realizimit të projekteve kapitale të financuara nga MAPL në mënyrë që të ngritet përgjegjësia dhe llogaridhënia në nivel më të lartë.	po		
	Ministri duhet të siguroj që në të ardhmen MiM-të respektohen plotësisht me qëllim që të eliminohen mangësi të njëjta. Në rast të nevojës për ndryshime të MiM-së të merren parasysh të gjitha implikimet financiare që mund të pasojnë për të gjitha palët e përfshira në bashkëfinancim.	po		
	Ministri duhet të siguroj që para fillimit të procedurave të prokurimit të bëhen analiza të duhura lidhur me nevojat reale të MAPL-së me qëllim që objektivat e caktuara të arrihen me një kosto më racionale.			jo
4.3.Pasurite dhe obligimet	Ministri duhet të siguroj se pasuritë menaxhohen sipas kërkesave ligjore për të siguruar që pasuritë ruhen nga humbja apo keqpërdorimi. Për këtë qëllim, duhet të siguroj që inventarizimi dhe vlerësimi i pasurive kryhet çdo vit.		Pjesërisht	
4.4.Trajtimi i borgjeve	Ministri duhet të analizoj arsyet për rritjen e obligimeve dhe të siguroj që aktivitetet për projekte kapitale janë planifikuar me kohë me qëllim që obligimet të mos ngarkojn buxhetin e vitit vijues. Veç kësaj , duhet të siguroj që para incimit të furnizimit me mallra dhe shërbime ekziston buxhet i mjaftueshëm për pagesën e tyre.		Pjesërisht	
5.Auditimi i brendshem	Ministri duhet të punojë me Drejtorin e NjAB-së për të siguruar që ofrohet siguri e mjaftueshme nga NjAB për funksionimin e kontrolleve në fushat ku vlerësimi i rreziqeve është paraparë i lartë. Në vitet e ardhshme përmbushja e aktiviteteve të planifikuara të NjAB-së duhet të monitorohet nga Komiteti i Auditimit çdo dy muaj dhe të ndërmer veprime proaktive, në mënyrë që devijimet nga plani të adresohen në kohën e duhur.		Pjesërisht	